QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PRISHTINË, MARS 2020

RAPORTI I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË



RAPORTI I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË

PRISHTINË, MARS 2020

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Autorë:
Liridona Ademaj
Skord Retkoceri

Dizajn dhe Layout:
Envinion

Prishtinë, mars 2020



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

Shkurtesa dhe definime 7

Hyrje 8

Çka është Agjencia e Kosovës për Akreditim
dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë? 9

Legjislacioni 10

Procesi i akreditimit/riakreditimit dhe tërheqjes së akreditimit 12

Vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) 14

Lista e institucioneve të arsimit të lartë me dhe pa akreditim 16

Programet studimore të akredituara në
Institucione të Arsimit të Lartë 18

Ndërhyrjet dhe parregullsitë në AKA 20

Sfidat e agjencisë së kosovës për akreditim dhe
Këshillit shtetëror të cilësisë 24

Projektet në zhvillim të AKA-së 27

SHKURTESA DHE DEFINIME

- **AKA –** Agjencia e Kosovës për Akreditim, është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit
- **KShC –** Këshilli Shtetëror i Cilësisë, është organ politikbërës dhe vendimmarrës i AKA-së, i cili përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve janë ndërkombëtarë
- **IAL –** Institucion i Arsimit të Lartë
- **Akreditim –** Njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuara të cilësisë, përmes të cilit përcaktohet statusi zyrtar i institucionit të arsimit të lartë dhe programeve të tij të studimit për një periudhë kohore
- **ENQA –** Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **EQAR -** Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **Bartës –** Çdo institucion i themeluar ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë
- **Bartës publik –** Bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- **Program –** Program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë
- **Komision i Ankesave –** Organi i cili trajton dhe shqyrton ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të KShC-së, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë

HYRJE

Viteve të fundit, Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë shpesh-herë kanë zënë ballinat e gazetave ditore, televizioneve dhe tabloideve vendore.

Pavarësisht se kjo agjenci është e pavarur në vendimmarrje, ndërhyrjet politike nga jashtë dhe parregullsitë nga brenda, ndikuan në degradimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2019.

ORCA ka marrë pjesë në mbledhjet e mbajtura nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, përmes të cilave është informuar për sfidat me të cilat përballen gjatë punës së tyre, bordi dhe AKA në përgjithësi.

Në mënyrë që të sigurohet pavarësi e plotë dhe efikasitet më i lartë në proceset e ven-dimmarrjes për akreditimin e institucioneve dhe programeve, si dhe në funksionimin më të mirë, agjencisë i nevojitet një ligj i veçantë, staf i mjaftueshëm, si dhe krijimi dhe mirëm-bajtja e databazave të nevojshme.

ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË?

AKA është themeluar në vitin 2004 dhe ka filluar operimin e saj, si trup formal për akreditim në Kosovë që nga viti 2009. AKA është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Agjencia është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton standardet dhe harton procedurat e saj për sigurimin e cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë.

AKA përbëhet nga bordi i saj - Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), i cili është organ politikbërës dhe vendimmarrës, si dhe struktura e përhershme administrative e AKA-së.

KShC merr vendim për akreditim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet, por asnjë vendim i KShC-së për akreditim/riakreditim nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar.

Anëtarë vendorë të KShC-së në përbërjen e tanishme janë Gazmend Luboteni - Kryetar, Vjollca Krasniqi - Nënkryetare, Arta Jakupi, Dukagjin Zeka, Rozafa Koliqi dhe Osman Ismaili, ndërsa anëtarë ndërkombëtarë janë Herbert Amato, Magdalena Ziolo dhe Jeffery Butel.

LEGJISLACIONI

Agjencia e Kosovës për Akreditim, aktualisht punon duke u bazuar në *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*[1], konkretisht me **Nenin 7** *'Agjencia e Kosovës për Akreditim'*, në të cilin sqarohet se AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, andaj edhe siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

AKA është përgjegjëse për inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë e Arsimit lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave, kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, vlerësimin periodikë të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar, si dhe shpalljen e politikave, kritereve dhe standardeve për akreditim.

Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës[2], përcakton kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

AKA funksionon edhe me Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)[3], përmes të cilës përcaktohet funksionimi, përbërja, mënyra e marrjes së vendimeve, detyrat dhe mënyra e punës (thirrja e mbledhjes mbajtja e mbledhjeve, mënyra e marrjes së vendimeve) së këtij këshilli.

Në **Nenin 7** të kësaj rregulloreje, *'Përgjegjësitë dhe funksionet e KShC-së'*, thuhet se KShC përcakton objektivat kryesore dhe afatet kohore të procesit të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), miraton Standardet, Procedurat dhe Kriteret e vlerësimit të jashtëm të IAL-ve të hartuara nga AKA.

1 http://www.akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Ligji_AL_RKS_04_L_037.pdf
2 https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf
3 https://drive.google.com/file/d/0B7etG3bh-SBVVkt4T2J5bmZuOTdYVFN4bFZmMnFwakx3Z0tR/view

Ky këshill, gjithashtu harton dhe miraton statutin e AKA-së, rregulloret dhe dokumentet tjera të nevojshme për funksionimin e Agjencisë.

Në *'Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave'* [4], përcaktohen rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave, si dhe rregullohet puna, organizimi dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave.

Neni 4 i kësaj rregullore, *'E drejta e ankesës'*, sqaron se palët mund të paraqesin ankesë nëse vendimi është marrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimit të KShC-së, në rast të zbatimit të gabuar të ligjit material apo rregullave materiale të zbatueshme dhe nëse vendimi nuk bazohet në faktet dhe provat e prezantuara.

Në Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e institucioneve të Arsimit të lartë [5], në **Nenin 2**, është shtuar pjesa ku thuhet se IAL-ve të cilave u është refuzuar apo tërhequr akreditimi institucional apo i programeve të studimit, mund të aplikojnë përsëri brenda periudhës prej 90 ditëve nga pranimi i vendimit përfundimtar.

Si dhe i është lejuar AKA-së, që të verifikojë të dhënat e paraqitura nga IAL në çdo kohë.

Ndërkohë që në *Udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë* [6], është shtuar se stafi akademik i cili është i deklaruar brenda institucionit sipas afateve ligjore edhe ata të cilët nuk janë deklaruar në asnjë IAL, kanë të drejtën e riaplikimit në afat prej 90 ditësh pas marrjes së vendimit përfundimtar refuzues.

4 http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf
5 https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf
6 https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf

PROCESI I AKREDITIMIT/ RIAKREDITIMIT DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT

Akreditimi mund të bëhet në nivelin e institucionit të arsimit të lartë, programit të studimit, degës dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në atë degë dhe njohjes së akreditimit valid ndërkombëtar.

Kërkesën për akreditim mund ta bëj vet institucioni i arsimit të lartë, për nivelin e institucionit dhe programeve të tij të studimit, Ministria e Arsimit (MAShT) dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në raste specifike.

Akreditimit fillestar i nënshtrohet secili institucion, i cili pretendon të ofrojë arsim të lartë në Kosovë, ndërkohë që riakreditimit, i nënshtrohen institucionet e akredituara të arsimit të lartë në baza periodike.

Institucioni i Arsimit të Lartë(IAL), i cili aplikon për akreditim/riakreditim, duhet të dorëzojë kërkesën për akreditim bashkë me listat e stafit akademik, për të cilat KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program studimi.

Nëse vlerësimi preliminar nga KShC është pozitiv, nënkuptohet se aplikacioni i plotëson kushtet formale sipas akteve juridike në fuqi duke autorizuar drejtorin e AKA-së, për zhvillim të procedurave për procesin e vlerësimit dhe akreditimit.

Ndërkaq nëse vlerësimi preliminar është negativ dhe KShC konstaton se aplikacioni ka mangësi dhe nuk i plotëson kushtet formale, atëherë KShC merr vendim për refuzim të aplikacionit.

Pas aprovimit të listës së stafit akademik dhe aplikacionit, AKA pranon një raport të vetëvlerësimit nga institucioni përkatës, të cilin pastaj do t'ia përcjellë ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë.

Ky ekip shkruan një raport të jashtëm të vlerësimit të cilësisë së institucionit aplikues apo të programeve të tij të studimit, duke u bazuar në standardet dhe udhëzuesit për akreditim, në të cilin ofrohet edhe rekomandimi final për riakreditim apo mosakreditim.

Pas vlerësimit të këtij raporti, KShC vendosë për akreditim/riakreditim apo ta refuzojë.

AKA-së i lejohet që në periudhën prej një viti, t'i trajtojë aplikacionet, prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim.

Këto aplikacione, duhet të dorëzohen në Agjenci më së largu me 31 tetor.

Akreditimi institucional fillestar është tri vite dhe riakreditimi jo më shumë se pesë vite, përveç rasteve kur ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër e cila merr pajtimin e bordit të KShC-së. Ndërkohë, kohëzgjatja e riakreditimit të programit studimor, është tri deri në pesë vite, pos rasteve me rekomandim ndryshe.

AKA mund ta tërheq vendimin e saj për akreditim në çfarëdo kohe, nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur, nëse aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumente të rreme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit, si dhe nëse raporti i monitorimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë konstaton se rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm nuk janë implementuar dhe gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë.

Ankesat e parashtruara nga IAL-ët kundër vendimeve të KShC-së, trajtohen nga Komisioni i Ankesave, i cili shqyrton ankesën dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të saj.

VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC)

Gjatë vitit 2019, KShC ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, në të cilat ka vendosur për akreditim dhe mosakreditim të programeve dhe institucioneve të arsimit të lartë (IAL) publik dhe privat.

KShC i ka dhënë akreditim institucional gjithsej 10 Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), 9 private dhe 1 publike. Ndërkohë që nuk i ka dhënë akreditim institucional 3 IAL-ve publike dhe 4 IAL-ve private.

Në IAL publike, KSHC ka akreditуar 25 programe Bachelor, 20 Master dhe ka dhënë 4 vendime për vazhdim të akreditimit në programe të doktoratës, ndërkohë që ka dhënë vendim për mosakreditim të 8 programeve Master.

Në IAL private, është dhënë vendim për akreditim të 31 programeve Bachelor, 20 Master dhe 2 programe të integruara (Dr. Dent), ndërkaq nuk i ka akreditуar 6 programe të nivelit Bachelor dhe 1 të nivelit Master.

VENDIMET E KSHC-SË PËR PROGRAME

Institucionet Publike			Institucionet Private		
	Akreditim	Mosakreditim		Akreditim	Mosakreditim
Programe Bachelor	25	0	Programe Bachelor	31	6
Programe Master	20	8	Programe Master	20	1
Programe PhD	4	0	Programe të integruara	2	0
Gjithsej ven-dime	49	8	Gjithsej ven-dime	53	7

Komisioni i Ankesave ka trajtuar gjithsej 25 ankesa, ku janë aprovuar **5** prej tyre, **4** nga **IAL private** dhe 1 nga IAL publike, 9 ankesa janë refuzuar, **6** nga **IAL private** dhe **3** nga **IAL publike.**

Janë shtyrë 10 ankesa, 9 nga IAL private dhe **1** nga **IAL publike**, si dhe një ankesë nuk është trajtuar për arsye se Institucioni i Arsimit të Lartë ka tërhequr ankesën.

Numri i programeve studimore që kanë pasur akreditim gjatë vitit 2019 në **IAL publike** është **173**, ndërsa në **IAL private** është **120.**

Nëse e krahasojmë me numrin e akreditimeve të programeve para emërimit të bordit aktual, rezulton se në marrjen e mandatit, ky bord kishte gjetur **220** programe të **IAL-ve publike** me akreditim dhe **122** programe të **IAL-ve private.**

Aktualisht me akreditim institucional, janë **6 IAL publike** dhe **15 IAL private.** Ndërsa në marrjen e mandatit, ky bord kishte gjetur me akreditim institucional gjithsej **9 IAL publike** dhe **21 IAL private.**

Pa akreditim institucional, janë **3 IAL publike** dhe **8 IAL private.**


INSTITUCIONET ME DHE PA AKREDITIM

INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË



Me akreditim:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike
- Fakulteti i Studimeve Islame



Pa akreditim:


- Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”

INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË



Me akreditim:

- Kolegji AAB
- AUK
- Kolegji Dardania
- Kolegji Dukagjini
- Kolegji ESLG
- Akademia Evolucion
- Kolegji Arbëria
- International Business College Mitrovica (IBCM)
- Kolegji Heimerer
- Kolegji “Pjetër Budi”
- Kolegji Rezonanca
- Kolegji Riinvest
- Kolegji UBT
- Kolegji Universi
- Kolegji Universum



Pa akreditim:

- Kolegji Biznesi
- Kolegji Fama
- Kolegji Globus
- Kolegji Iliria
- Kolegji ISPE
- Kolegji Juridica
- Kolegji Tempulli
- Kosovo Art Academy

PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

Programet studimore të akredituara në IAL publike sipas nivelit të studimeve[7] janë si më poshtë;

Aktualisht të akredituara janë gjithsej 81 programe të nivelit Bachelor, 31 të nivelit Bachelor i Arteve, 41 të nivelit Bachelor i shkencës, 2 prej të cilave janë të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 2 të nivelit Bachelor i Juridikut, 2 të nivelit Bachelor i Muzikës, 1 të nivelit doktor i Mjekësisë Veterinare, 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë.

Ndërsa në nivelin Master janë gjithsej 72 programe studimore, 29 të nivelit Master i Arteve, 32 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 1 të nivelit Master profesional, 6 të nivelit Master i Juridikut, 2 të nivelit Master i Muzikës, 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike.

Në nivelin e doktoratës janë 14 programe, në nivelin doktoratë e shkencës, janë akredituar 5 programe.

Programet studimore të akredituara në IAL private sipas nivelit të studimeve[8] janë si më poshtë;

Aktualisht të akredituara janë gjithsej 76 programe të nivelit Bachelor, 39 të nivelit Bachelor i Arteve, 28 të nivelit Bachelor i shkencës, 1 të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 3 të nivelit Bachelor profesional, 5 të nivelit Bachelor i Juridikut, 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë.

Ndërsa në nivelin Master, janë gjithsej 41 programe studimore, 18 të nivelit Master i Arteve, 15 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 6 të nivelit Master i Juridikut, 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike dhe 1 të nivelit të pestë.

7 http://akreditimi-ks.org/docs/Downloads/Accreditation/kshc20092019/kshc20092019.pdf
8 http://akreditimi-ks.org/docs/Downloads/Accreditation/kshc20092019/kshc20092019.pdf

NUMRI I PROGRAMEVE STUDIMORE TË AKREDITUARA NË IAL

Lloji i diplomës	Publik	Privat	Total
Bachelor i Arteve	31	39	70
Bachelor i Shkencës	41	28	69
Bachelor i Arteve (Profesional)	2	1	3
Bachelor Profesional	-	3	3
Bachelor i Juridikut	2	5	7
Bachelor i Muzikës	2	-	2
Doktor i Mjekësisë (integruar)	1	-	1
Doktor i Mjekësisë Dentare (integruar)	1	1	2
Doktor i Mjekësisë Dentare	-	1	1
Doktor i Mjekësisë Veterinare (integruar)	1	-	1
Master i Arteve	29	18	47
Master i Shkencës	32	15	47
Master i Arteve (Profesional)	1	1	2
Master Profesional	1	-	1
Master i Juridikut	6	6	12
Master i Muzikës	2	-	2
Master i Shëndetësisë Publike	1	1	2
Niveli i pestë	-	1	1
Doktoratë	14	-	14
Doktor i Shkencës	5	-	5
TOTAL	**172**	**120**	**292**

NDËRHYRJET DHE PARREGULLSITË NË AKA

Përjashtimi nga ENQA dhe EQAR

Agjencia e Kosovës për Akreditim ishte bërë pjesë e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në vitin 2014, ndërsa ishte pranuar në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) në vitin 2015.

Kërkesa e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj ndaj ish-ministrit të Arsimit, Shyqiri Bytyqi, për shkarkimin e bordit dhe drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim [9], rezultoi me përjashtimin e kësaj agjencie nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) në vitin 2017.

EQAR në vendimin e saj konsideronte se AKA nuk funksionon më si e pavarur, prandaj edhe nuk i përmbush standardet evropiane të agjencive të akreditimit.

Për të njëjtën arsye, në vitin 2018-të ENQA vendosi që Agjencisë së Kosovës për Akreditim t'ia reduktojë pozitën, nga anëtare e rregullt në anëtare nën vëzhgim.

Anëtarët e rinj të këtij bordi, u zgjodhën përmes një procesi transparent i cili kaloi përmes votimit të anëtarëve nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës [10].

Në shtator të 2019-ës, kjo agjenci pranoi edhe vendimin përfundimtar të ENQA-së [11], në të cilin thuhej se AKA-së nuk i ishte vazhduar anëtarësia, me arsyetimin se nuk i përmbushin më standardet dhe rregullat evropiane, si dhe kishte mangësi të theksuara në udhëheqjen e saj.

ENQA kishte kritikuar agjencinë për mospunësimin e zyrtarëve të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve që ofron AKA, sipas ligjit në fuqi, metodologjinë e punës, përfshirjen e studentëve dhe pavarësinë e veprimit.

9 http://www.akreditimi-ks.org/neë/index.php/sq/homepage-2/98-kaa-articles-2/lajmet/377-sqarim-per-opinionin-publik
10 http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/homepage-2/98-kaa-articles-2/lajmet/379-kshc55
11 https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/KAA-external-review-report.pdf

Më poshtë mund t'i gjeni edhe disa prej kritikave dhe rekomandimeve [12]:

- Zhvillimi i Planit Strategjik dhe përfshirja e studentëve në aktivitete dhe procesin e vendimmarrjes në AKA
- Garantimi i pavarësisë formale dhe operacionale
- Sigurimi i resurseve adekuate njerëzore dhe financiare
- Monitorimi i zbatimit të standardeve
- Përmirësimi i cilësisë së raporteve me analiza më të thella

Problemi me tejkalimin e kuotave në regjistrimin e studentëve

Në janar të vitit 2020, një medium kishte publikuar lajmin se Inspektorati i Arsimit në MAShT kishte bërë kallëzim penal ndaj Kolegjit UBT në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe se ishin hapur hetime nën dyshimin se kishin tejkaluar numrin maksimal të regjistrimit të studentëve [13].

Edhe pse përcaktimi i kuotave apo numrit të studentëve është përgjegjësi e AKA-së, kjo e fundit nuk kishte marrë masa ndaj kolegjit në fjalë apo ndaj IAL-ve të tjera që dyshohen për shkelje të ngjashme.

12 https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/KAA-external-review-report.pdf
13 https://frontonline.net/prokuroria-nis-hetimet-ndaj-kolegjit-ubt-regjistroi-1236-studente-me-shume/

Ndërhyrje të tjera në pavarësinë e AKA-së

Pas tërheqjes së akreditimit institucional të tri universiteteve publike [14] në korrik të 2019 dhe gjashtë kolegjeve private [15], si dhe dhjetëra programeve studimore, ish-kryeministri Haradinaj përsëri ndërhyri në punën e agjencisë, duke i quajtur mafiozë [16] anëtarët e këtij bordi.

Vendimeve të KShC-së, në mbrojtje i dolën ambasada e Amerikës, Evropës dhe Britanisë së Madhe, mirëpo përveç këtyre ndërhyrjeve politike, AKA u përballë edhe me ndërhyrje të diplomatëve që veprojnë në Kosovë.

Në media ishte bërë publike letra e ambasadorit të Gjermanisë, Christian Heldt [17], të cilën ia kishte dërguar kryetarit të KShC-së, Gazmend Luboteni përmes së cilës rekomandonte thirrjen e një mbledhjeje në mënyrë që të vendoset për Kolegjin Heimerer [18].

Tre anëtarët vendorë të KShC-së, Dukagjin Zeka, Arta Jakupi dhe Rozafa Koliqi, kanë lëshuar mbledhjen e mbajtur me 16-17 janar të 2020-ës, nën dyshimet se procesi i akreditimit të disa programeve studimore është manipuluar [19].

Kryetari i KShC-së, Gazmend Luboteni dhe ish-ushtruesi i detyrës së drejtorit të AKA-së, Avni Gashi mohuan se procesi për akreditim të disa programeve të tri kolegjeve private u manipulua [20], mirëpo tre anëtarët e KShC-së që ngritën këto dyshime, pohuan se raportet e vlerësimit për programet e Kolegjit Rezonanca, Kolegjit Heimerer dhe Kolegjit ISPE, u bënë në afat rekord.

Sipas UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, Agjencia ka kohë një vit për trajtimin e kërkesave për akreditim, pas pranimit të aplikacioneve.

14 https://kallxo.com/shkurt/universitetet-e-pejes-prizrenit-dhe-mitrovices-nuk-mund-te-regjistrojne-studente-te-rinj/
15 https://kallxo.com/shkurt/pervec-tri-universiteteve-publike-kshc-ua-terheq-akreditimet-edhe-4-kolegjeve-private/
16 https://kallxo.com/arsim/haradinaj-serish-i-reagon-kshc-se-nuk-mund-ti-leni-maturantet-ne-rruge/
17 https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=410886
18 https://www.gazetaexpress.com/gjinovci-pretendon-se-ambasadori-gjerman-ka-nderhyre-ne-agjencine-e-akreditimit-per-kolegjin-heimererx/
19 https://www.koha.net/arberi/204577/dyshime-per-dallavere-ne-akreditimin-e-programeve-te-disa-kolegjeve-private/
20 https://www.koha.net/arberi/204777/udheheqesit-e-akreditimit-mohojne-se-procesi-i-akreditimit-te-kolegjeve-eshte-i-manipuluar/

Në një medium tjetër, është publikuar një hulumtim përmes të cilit është publikuar rrëfimi i një studenteje të Kolegjit Rezonanca, e cila pretendonte se ishte mashtruar nga ky kolegj se kishin akreditim në programin ku ajo ishte regjistruar [21].

Kolegji në fjalë, kishte deklaruar se besonte që KShC do t'iu jepte akreditim për vitin akademik 2019/2020 meqenëse u lejohet riaplikimi sipas UA të ri dhe nëse nuk u jepet akreditim për këtë vit akademik, ata do ta padisin këtë institucion [22].

Në janar të vitit 2020, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, përsëri tentoi të ndërhyjë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim [23], përmes një letre të cilën ia kishte dërguar kryetarit të KShC-së, dhe ish-ushtruesit të detyrës së drejtorit të AKA-së, në të cilën akuzonte AKA-në për procedura të tejzgjatura dhe pengesa administrative në procesin e akreditimit për disa kolegje private.

Pas kësaj letre, reagoi drejtori i Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e lartë (EQAR), Colin Tück, i cili i bëri thirrje bordit të AKA-së që të kenë kujdes se si e shqyrtojnë këtë letër [24], duke shtuar se veprimet e AKA-së mund të rishikohen vetëm nga gjykata.

21 https://kallxo.com/lajm/kolegji-rezonanca-tregon-pse-i-nisi-studimet-ne-programet-qe-nuk-ishin-akredituar/
22 https://kallxo.com/lajm/kolegji-rezonanca-tregon-pse-i-nisi-studimet-ne-programet-qe-nuk-ishin-akredituar/
23 https://kallxo.com/lajm/dokument-haradinaj-i-perzihet-serish-puneve-te-agjencise-se-akreditimit/
24 https://www.koha.net/arberi/209066/eqar-i-i-shqetesuar-me-veprimet-e-qeverise-se-kaluar-kerkon-kujdes/

SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË

Mungesa e databazës për nevojat e tregut të punës

Deri tash nuk është përgatitur një dokument/databazë nga ana e Ministrisë së Arsimit [25], Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale [26], Agjencisë së Kosovës për Akreditim [27], Agjencisë së Statistikave të Kosovës [28] dhe Agjencisë së Punësimit [29], i cili analizon nevojat e tregut të punës.

Kjo lloj databaze, do të publikohej në faqen zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes të cilës të interesuarit për studime universitare, do të informoheshin dhe orientoheshin për programet të cilat i nevojiten tregut të punës. Si dhe do t'i shërbente Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të marrjes së vendimit për akreditimin e programeve studimore.

Mungesa e shkëmbimit të informacioneve për stafin akademik në nivel rajonal

Nevojitet një databazë e tillë, e cila do të shërbente për informimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, brenda dhe jashtë vendit, për përbërjen e stafit akademik në institucionet e akredituara, në mënyrë që t'u pamundësohet profesorëve që të angazhohen si staf i rregullt, në më shumë se një institucion të arsimit të lartë në shtete të ndryshme.

Gjithashtu do t'i shërbente edhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të shqyrtimit të stafit akademik të IAL-ve të cilat aplikojnë për akreditim apo riakreditim.

25 https://masht.rks-gov.net/
26 https://mpms.rks-gov.net/
27 http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/
28 https://ask.rks-gov.net/
29 https://aprk.rks-gov.net/

Problemet me platformën E-akreditimi

Kjo platformë [30] e cila është ndërtuar dhe menaxhohet nga Ministria e Arsimit, sipas zyrtarëve të AKA-së, konsiderohet e cilësisë së ulët pasi shpeshherë nuk funksionon dhe ka dy vite që nuk ka mirëmbajtje, kjo edhe për shkak të mungesës së zyrtarit të IT-së në Agjenci.

Mungesa e stafit në AKA

Aktualisht AKA funksionon përmes pesë zyrtarëve; Ushtruesit të detyrës së drejtorit të AKA-së, zyrtares për administratë dhe personel, zyrtares për buxhet dhe financa, zyrtares për monitorim dhe vlerësim, si dhe zyrtarit për vlerësim dhe akreditim.

Në gusht të vitit 2019-të, AKA kishte hapur konkurs për pesë pozita [31]; Zyrtar i Lartë Ligjor, Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Vlerësim, Zyrtar i Lartë për Vlerësim dhe Akreditim, Zyrtar i Lartë i Personelit, si dhe Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative, mirëpo ky konkurs është anuluar në shkurt të 2020'ës [32].

Vështirësitë administrative në proces të rekrutimit, kriteret, ngarkesa e punës në krahasim me pagën e zyrtarëve, cilësia e shqyrtimit të lëndëve, e shumë të tjera, kanë bërë që AKA ende të mos mund ta kompletojë stafin e nevojshëm, gjë që për pasojë nuk kanë arritur të bëjnë procesin e monitorimit të IAL-ve.

Sipas *Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2019*[33], Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i është ndarë buxheti për 13 pozita, por që sipas AKA-së, këto janë të pamjaftueshme.

Si pasojë e mungesës së stafit, AKA aktualisht shikon kriteret minimale për akreditimin e programeve studimore dhe akreditimin institucional. Pra bëhet rishikimi i numrit profesor-studentë, sasia e pajisjeve, si dhe hapësira e objektit të IAL-ve.

30 https://e-akreditimi.rks-gov.net/
31 http://www.akreditimi-ks.org/docs/Downloads/Konkurs/Shpalljetekonkursit-shq-sr.pdf
32 https://drive.google.com/file/d/1I9vqUvhZh9y_n91r-BEY1GfAa01g9HBv/view
33 https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf?

Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës ligjore

Propozohet krijimi i një ligj të veçantë për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përmes të cilit do të krijohej pavarësi e plotë institucionale, në mënyrë që funksioni i Agjencisë të jetë i përputhshëm me kriteret e Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe që do t'ia mundësonte AKA-së krijimin e politikave të veta.

Si pasojë e mungesës së një ligji të veçantë, MAShT ndër vite ka krijuar Udhëzime Administrative që ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e AKA-së, siç është shembulli me dy plotësim-ndryshimet e UA-së për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, të cilat ia mundësojnë IAL-ve riaplikimin pas 90 ditësh të marrjes së vendimit refuzues.

Gjithashtu kompetencat e Komisionit të Ankesave të përcaktohen përmes një Udhëzimi Administrativ, në të cilin do të bëhen plotësimet dhe ndryshimet për rifunksionalizimin e këtij komisioni.

Si dhe të shtohet numri i anëtarëve, nga 3 anëtarë të përhershëm dhe 2 rezervë, në një komision me 5 anëtarë, kriter ky i Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), i cili duhet plotësuar.

Komisioni i Ankesave

Këshilli Shtetëror i Cilësisë kishte konstituuar Komisionin e Ankesave (KA) në janar të vitit 2019.

Mirëpo kishte pezulluar punën e tyre në prill të po atij viti, pasi kishin kuptuar se versioni përfundimtar i rregullores me të cilën kishte qenë duke punuar Komisioni i Ankesave, nuk ishte votuar asnjëherë nga KShC, ndërkohë që ishte nënshkruar versioni në shqip nga kryetari i bordit, Gazmend Luboteni, si dhe pas informimit se KA kishte filluar të jap vendime për kthim të akreditimit të programeve studimore.

Në interpretimin e Udhëzimit Administrativ nga ana e Ministrisë së Arsimit, në Nenin 22, i cili flet për të drejtën ankimore, thuhej se Komisioni i Ankesave nuk mund t'i jap ose heq akreditimin një institucioni të arsimit të lartë.

Andaj në maj të 2019-ës, KShC kishte miratuar rregulloren e punës së Komisionit të Ankesave.

Në gusht të po atij viti, anëtarët e Komisionit të Ankesave kishin dhënë dorëheqje dhe ankesat e pranuara pas kësaj periudhe, kanë mbetur pa përgjigje dhe janë udhëzuar për në gjykatë.

PROJEKTET NË ZHVILLIM TË AKA-SË

Agjencia e Kosovës për Akreditim aktualisht është e angazhuar në gjashtë projekte:

- Miratimi i udhëzuesit për monitorim
- Plani strategjik i agjencisë
- Platforma për trajnimin e ekspertëve
- Rishikimi dhe plotësimi i standardeve për nivelin e studimeve Bachelor dhe Master
- Rishikimi i standardeve për doktoratë
- Plani i veprimit për përmbushjen e standardeve të ENQA's

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencionit Austriak për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center
ORCA organizata për nisjen e cikleve në oraim
ZSI CENTRUM FÜR SOZIALE INNOVATION CENTRE FOR SOCIAL INNOVATION